



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 817/1 prot.

Tiranë, më 08.07.2020

Lënda: Sugjerime mbi projektligjin “*Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit*”.

Znj. ANILA DENAJ
MINISTËR
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në vëmendje të:

**Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator
Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë**

TIRANË

E nderuar zonja Ministre,

Në vijim të shkresës Tuaj Nr. 11844/1 prot, datë 23.06.2020, protokolluar me tonën me Nr. 817 prot, datë 24.06.2020, për dhënie mendimi në lidhje me projektligjin “*Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është konsultuar me këtë projekt-ligj, Relacionin shpjegues, RIA dhe Tabelat e përputhshmërisë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi konsultimit me këto akte, parashtron mendime, brenda fushës së veprimit dhe mandatit të tij, sa i takon zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Paraprakisht, evidentuam se, projektligji “*Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit*” përpunohet pjesërisht me Direktivën 2009/103/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009, “*Për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë.*” Gjatë hartimit të aktit janë marrë parasysh gjithashtu aktet ligjore të disa vendeve të rajonit, me qëllim edhe standardizimin e legjislacionit vendas me atë të vendeve fqinje, me problematika të ngjashme të tregjeve financiare.

Megjithatë, ka një parashikim në nenin 2 pika 2 të projektligjit, që rezulton të jetë përafruar pjesërisht me Nenin 5, Paragrafi 1, të Direktivës 2009/103/KE, referuar Tabelës së Përputhshmërisë TPL, ku parashikohet:

Projektligji “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”

Neni 2 - Fusha e veprimit

“*2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për kategorinë të veçanta mjetesh motorike të Forcave të Armatosura, të cilat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.*”

Direktiva 2009/103/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit “Për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë”

Nenin 5 - Përjashtimi nga detyrimi në lidhje me sigurimin e detyrueshëm të automjeteve

“*1. Një Shtet Anëtar mund të mos e zbatojë nenin 3 në lidhje me disa persona të caktuar fizikë ose juridikë publikë ose privatë; Shteti në fjalë përpilon një listë të këtyre personave, të cilën ua komunikon Shteteve Anëtare të tjera dhe Komisionit.*

Shteti Anëtar që vendos të mos e zbatojë nenin 3 merr masat e duhura për të siguruar që të paguhet kompensim në lidhje me çdo humbje ose dëmtim të shkaktuar në territorin e tij dhe në territorin e Shteteve Anëtare të tjera nga automjete që u përkasin personave të tillë.Ai i komunikon Komisionit listën e personave të përjashtuar nga sigurimi i detyrueshëm dhe të autoriteteve dhe organeve përgjegjëse për kompensimin.

2. Një Shtet Anëtar mund të mos e zbatojë nenin 3 në lidhje me disa lloje të caktuara automjeteve ose disa automjete të caktuara që mbajnë një targë të posaçme; Shteti në fjalë përpilon një listë të këtyre llojeve ose të këtyre automjeteve, të cilën ua komunikon Shteteve Anëtare të tjera dhe Komisionit.

Çdo Shtet Anëtar që bën përjashtimin e lartpërmendur siguron që automjetet e përmendura në paragrafin e parë të trajtohen në të njëjtën mënyrë me automjetet për të cilat nuk është përbushur detyrimi për sigurim i parashikuar në nenin 3.”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se, **neni 2, pika 2 e projektligjit përmban një kriter përjashtues**, sipas të cilës dispozitat e tij nuk zbatohen për kategorinë të veçanta mjetesh motorike¹ të Forcave të Armatosura.

Ky parashikim i referohet një rregulli të përgjithshëm të legjislativës europiane, sipas të cilës mund të mos zbatohet *sigurimi i detyrueshëm i automjeteve* (neni 3)², në lidhje me disa persona

¹ Sipas përkufizimeve në nenin 3 pika 3 të projektligjit: “*Mjet motorik*” është mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekti i detyrimit për regjistrim. *Mjet motorik* është edhe rimorkoja dhe gjysmërimorkoja të bashkuara ose jo me mjetin motorik tërheqës.

² Neni 3 i Direktivës parashikon Sigurimi i detyrueshëm i automjeteve, ku thuhet “*Çdo Shtet Anëtar, në varësi të nenit 5, merr të gjitha masat e duhura për të siguruar që përgjegjësia civile e lidhur me shfrytëzimin e automjeteve që përdoren normalisht në territorin e tij të jetë e mbuluar me sigurim.*”.

të caktuar fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, dhe se Shteti në fjalë përpilon një listë të këtyre personave, të cilën ua komunikon Shteteve Anëtare të tjera dhe Komisionit.

Pra, Direktiva e njeh përjashtimin, duke e lënë në diskrecionin e shteteve, mundësinë e mos zbatimit të sigurimit të detyrueshëm, duke vendosur detyrimin që vetë shteti të sigurojë që të paguhet kompensimi, në lidhje me çdo humbje ose dëmtim të shkaktuar në territorin e tij dhe në territorin e Shteteve Anëtare të tjera nga automjete që u përkasin personave të tillë.

Në lidhje me sa më lart, **Komisioneri konstaton se në Relacionin shpjegues të këtij projektligji, nuk është shpjeguar përbajtja e nenit 2, dhe arsyja se pse është vendosur ky përjashtim për Forcat e Armatosura**. Aq më tepër që kjo dispozitë përputhet pjesërisht me Direktivën 2009/103/KE dhe nuk përmban asnjë shpjegim, as në tabelën e përputhshmërisë të këtij projektligji, në rubrikën “Shënime”. Mendojmë se, përsa kohë që niveli i përputhshmërisë është i pjesshëm, në tabelën e përputhshmërisë do duhej të sqaroheshin pjesa e dispozitës që nuk përafrohet dhe arsyet e saj.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon përjashtime nga e drejta për mosdiskriminim. Konkretisht, trajtimi i ndryshëm i përligjur, i parashikuar në nenin 6 të këtij ligji, njeh që ndalimi i diskriminimit nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga R.Sh. dhe legjislacioni në fuqi.

Për këtë arsy, **Komisioneri vlereson se nuk ka një shpjegim të shprehur lidhur me faktin nëse ky kriter, për përjashtimin e një kategorie të veçanta mjetesh motorike të Forcave të Armatosura**, ndjek një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur.

Në të kundërt, pra në mungesë të qëllimit objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur, kriteri për përjashtimin e mjeteve të Forcave të Armatosura, mund të përbëjë një kriter diskriminues, gjë që bie në kundërshtim me Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



